



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Kamëz, më 03/03/2024

Nr. 30 prot.

V E N D I M

Nr 26 Datë 06/03/2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 103 DATË 18.12.2023 "PËR
MIRATIMIN E DETAJIMIT TË BUXHETIT PËR VITET 2024, 2025, 2026".**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.06/03/2024, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin nr.23 dt 05/03/2024,

Në mbështetje të:

- - Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin ,,
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Udhëzimin Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore "
- Udhëzimin Nr. 3 datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027 "
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02. 2022 , per nje ndryshim ne udhezimin nr.23 dt 23.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore "
- Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ", i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.

V E N D O S I

1. Në V.K.B nr 103 datë 18.12.2023 "përmiratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2024, 2025, 2026", të bëhen ndryshimet si më poshte:
 - Miratimin e ndryshimeve në tabelen e të ardhurave për vitin 2024 (fondet që trashëgohen) sipas akt- rakordimit me thesarin.
 - Miratimin e ndryshimeve në tabelën e funksionimit dhe investimeve, për vitin 2024
 - Miratimin e ndryshimit të pikes 13 te V.K.B nr. 103 date 18.12.2023 për ndryshim të punonjëve të ndërmarrjeve të varësisë, sipas tabelës nr.15/1 bashkëlidhur këtij projekt vendimi (ishte 266 punonjës bëhet 314 punonjës).
 - Miratimin e fondit për ekipin e sportit tae kwon do (wtf) Kamëz, ky fond do të meret nga fondi i kontigjencës.
 - Miratimin e struktures buxhetore për vitin 2024 (për ndryshimet) sipas tabelës bashkelidhur.
2. Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

ZV/KRYETAR I KESHILLIT

MUNIR SHEHU

